

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EXELLANCE CO” SH.P.K**

Sot, më datë 05 Gusht 2022 (*dymijë e njëzet e dy*), ditë e Premte, në Tiranë, Ne ortakët:

THEMELUES:

1. Znj. Nino MAGLAKELIDZE, atësia Davit, me shtetësi Gjeorgjane, lindur në Khoni, Georgia dhe banuese në Georgia, me adresë Tbilisi, Vaja Fshavela Avenue District 5 Bulding 4, Flat 149, e datëlindjes 13.08.1992, gjendja civile sipas vetë-deklarimit të saj “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me pasaportë Gjeorgjane nr. 20AC02966 dhe nr. personal 01001079776.

2. Z. Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN, atësia Roshdy, me shtetësi Egjiptiane, lindur në Kairo, Egjipt dhe banues në Georgia, me adresë në Tbilisi, Mamuka, kabuladze, str. #29, i datëlindjes 01.04.1978, gjendja civile vetë-deklarimit “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me pasaportë egjiptiane nr. A26187365.

Ne Themeluesit, konform ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; shprehim vullnetin tonë të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Dispozitat e Aktit të Themelimit të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Neni 1

Emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë është “EXELLANCE CO” sh.p.k (*këtu e në vijim referuar si “shoqëria”*)

Neni 2

Selia e shoqërisë

1. Selia e shoqërisë është në adresën: Tiranë, Njësia Administrative nr. 2, Rruga “Budi”, nr. 85, 1003. Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Adresa e postës elektronike për komunikimet elektronike për shoqërinë është excellencecoalb@gmail.com. Nr. cel i shoqërisë është 00355 695625639.
3. Ortakët mund të vendosin për transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër, si dhe të vendosin në lidhje me ndryshimin e të dhënave adresore apo mbylljen ose hapjen e degëve, zyrave të përfaqësimit, filialeve, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 4

Objekti i aktivitetit

1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare është: “Shërbime dixhitale, shërbime online, shërbime turistike, agjenci imobiliare, ndërmjetësimi, shërbime transporti, shërbime të ndryshme, etj.”
2. Ortakët kanë të drejtë të përcaktojnë modalitetet për zgjerimin apo zvogëlimin e fushës së aktivitetit të kryer.
3. Shoqëria zbaton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të

N. Mag
Mena Roshdy

Bkivela Kallaga

ndryshuar, për ushtrimin e veprimtarisë të saj.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë krijohet me mjetet financiare pronë e ortakëve **Nino MAGLAKELIDZE** në masën 50% dhe **Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN** në masën 50%. Kapitali themelor i shoqërisë është i barabartë me shumën 100 lekë (njëqind lekë) që përfaqëson **100%** të kuotave të kapitalit themeltar, të zotëruar nga ortakët **Nino MAGLAKELIDZE** në masën 50% dhe **Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN** në masën 50%.

Neni 6



Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të ortakëve të shoqërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
2. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

Neni 7

Asambleja e përgjithshme

1. Organ vendimmarrës në shoqëri është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që thirret në seancë të zakonshme të paktën dy herë në vit dhe drejtohet nga administratori/ët e shoqërisë. Asambleja merr vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në statut.
2. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga të dy ortakët në mënyrë të barabartë. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statut.
3. Vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
4. Çdo vendim i ortakëve që është i paregjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
5. Shoqëria nuk mund t'i kundër-drejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
6. Nëse shoqërisë i shtohen ortakë të tjetër përveç themeluesve, atëherë asambleja e përgjithshme do të thirret, mbledhet dhe vendosë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
7. Do të konsiderohen veprimtari të Shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform disponimeve në Statutin e Shoqërisë dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.
8. Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë të fushës që i përket objektit të veprimtarisë si dhe punonjës të tjerë me kontratë pune sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe përgjithësisht me legjislacionin shqiptar në fuqi.



9. Do të konsiderohen veprimtari të Shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform disponimeve në Statutin e Shoqërisë dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Administrimi i shoqërisë

1. Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtrohet legjislacionit përkatës shqiptar.
2. Shoqëria do të administrohet nga dy administratorë, të zgjedhur nga ortakët për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh, **të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë shoqërinë të dy së bashku ose veçmas njëri tjetrit me të drejta të plota, të palimituara.** Administratorët mund të rizgjidhen ose të shkarkohen nga ortakët e shoqërisë, me vendim asambleje.
3. Me themelimin e këtij akti, administratorë të shoqërisë caktohen **znj. Nino MAGLAKELIDZE dhe z. Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN**, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
4. Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortakë të tjerë të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërë në rastin e pranimit të tyre.
5. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë apo shtojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.
6. Administratorët gëzojnë të drejta të plota në lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, **të dy së bashku ose veçmas njëri tjetrit, me të drejta të plota, pa kufizim.** Administratorët mbajnë përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë dhe mund të delegojnë secili prej tyre tek të tretë, për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të shoqërisë.
7. Administratorët veprojnë në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme. Ata janë përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë, si dhe duhet të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë.
8. Shpërblimi i administratorëve përcaktohet nga ortakët e shoqërisë.
9. Çështjet e punësimit dhe marrëdhënies së punës së administratorëve rregullohet nga legjislacioni në fuqi për marrëdhëniet e punës, si dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

Neni 9

Kontrolli financiar

Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet nga auditues ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ortakët do të emërojnë një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi vlerësohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

Neni 10

Viti financiar

1. Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbyllet në fund të këtij viti.
2. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.







Neni 11

Bilanci vjetor dhe dividendi

1. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët e shoqërisë.
2. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga ortakët e shoqërisë brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
3. Ortakët vendosin mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë, sipas parashikimet të legjislacionit në fuqi.
4. Fitimi i nxjerrë nga aktiviteti i ligjshëm i kësaj shoqërie tregtare është në favor të ortakëve të shoqërisë në masën 50% për ortakun **Znj. Nino MAGLAKELIDZE** dhe 50% për ortakun **z. Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN**.
5. Ndërkohë ortakët mbartin mbi vete rrezikun e humbjes deri në masën 100% të kapitalit themeltar dhe atij rezervë, përkatësisht nga 50% secili prej ortakëve.
6. Për detyrimet që shoqëria mund t'ju ketë personave të tjerë juridikë apo fizikë përgjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.
7. Për funksionimin normal të shoqërisë do të hartohet statuti i shoqërisë ku do të parashikohen hollësitë e mirëfunksionimit dhe administrimit të saj.

Neni 12

Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

1. Në rast të prishjes dhe likuidimit të shoqërisë, do të zbatohet dispozitat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
2. Kjo shoqëri mund të mbyllë aktivitetin e vet në rastet e parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe në statutin e saj.

Neni 13

Legjislacioni

1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve të shoqërisë, administratorëve dhe personave të tjerë të punësuar në Shoqëri, në rast se nuk zgjidhen me pajtim, do të zgjidhen me ndërmjetësim ose nga gjykata kompetente.
3. Autorizojmë shtetasin shqiptar **Armand TELHALLARI**, i datëlindjes 28.03.1977, lindur në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit nr. 035603094 dhe nr. personal H70328056Q për të depozituar këtë akt themelimi online nëpërmjet e-Albania në QKB (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit).
4. Shoqëria do të marrë personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve.

Për sa më sipër, ne Ortakët themelues **Nino MAGLAKELIDZE** dhe **Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN**; hartuam Aktin e Themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**EXELLANCE CO**” Sh.p.k, në gjuhën shqipe, sipas legjislacionit Shqiptar, bazuar në vullnetin tonë të lirë e të plotë, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare në Shqipëri, në prani të përkthyeses zyrtare **Beslinda RRUGIA**, atësia Ilir, me shtetësi Shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, e datëlindjes 30.11.1982, madhore, me zotësi të plotë







juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 035779180 dhe nr. personal I26130042M, e cila nënshkruan në fund të aktit të themelimit.

Ne ortakët themelues jemi me shtetësi të huaj, përkatësisht **Nino MAGLAKELIDZE**, me shtetësi Gjeorgjiane, **ndërsa Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN**, me shtetësi Egjyptiane. Ne nuk kuptojmë dhe nuk flasim gjuhën Shqipe, por kuptojmë dhe flasim shumë mirë gjuhën Angleze. Për këtë arsye, ne kemi zgjedhur përkthyesen zyrtare **Beslinda RRUGIA**, atësia Ilir, me shtetësi Shqiptare, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, e datëlindjes 30.11.1982, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 035779180 dhe nr. personal I26130042M, që nënshkruan në fund të aktit të themelimit, e cila na e përktheu aktin e themelimit verbalisht në gjuhën që ne kuptojmë në gjuhën Angleze në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për ne. Pasi e kuptuam qartazi rëndësinë dhe efektet ligjore të saj, ne ortakët e shoqërisë **Nino MAGLAKELIDZE dhe Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN**, e nënshkruajmë Aktin e Themelimit të shoqërisë **“EXELLANCE CO” sh.p.k.** sipas ligjit, në prani të përkthyeses zyrtare.

Akti i Themelimit përbëhet nga 5 (pesë) faqe dhe lëshohet në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.

ORTAKËT THEMELUES TË AKTIT TË THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “EXELLANCE CO” sh.p.k.

Ortake e Shoqërisë

Nino MAGLAKELIDZE

Nino Maglakelidze


N. Mag



Përkthyesë Zyrtare

Beslinda RRUGIA

Beslinda Rrugia



Ortak i Shoqërisë

Mena Roshdy Nagiub SOLIMAN

Mena Roshdy Nagiub Soliman

Mena Roshdy